

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave Ministry of Internal Affairs and Public Administration Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police	
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

Policia e Kosovës

shpall

KONKURS

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2026/2027

Policia e Kosovës, për vitin akademik 2026/2027, do të regjistrojë **26 (njëzet e gjashtë)** studentë në vitin e parë të studimeve në **Fakultetin e Sigurisë Publike** të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), sipas kuotës së miratuar nga Bordi i AKSP-së për programin e studimeve **Bachelor në Siguri Publike**.

KUSHTET E KONKURSIT

Kushtet e përgjithshme

Të drejtë aplikimi kanë zyrtarët e Policisë së Kosovës të cilët plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të përfunduar me sukses arsimin e mesëm, të dëshmuar me diplomë;
2. Të jenë në marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës.

Kushtet e veçanta

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kritere:

- Të kenë së paku pesë (5) vite përvojë pune në Policinë e Kosovës;
- Të mbajnë njërën nga gradat: **Toger; Rreshter , Polic i Larte;**
- Të jenë nën moshën **45 vjeç** në momentin e aplikimit;
- Të jenë të sistemuar në nivel qendror ose lokal të Policisë së Kosovës;
- Të mos kenë dosje disiplinore aktive për shkelje të rënda dhe të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale;

- Të pranojnë obligimin që, pas përfundimit të studimeve, të shërbejnë në Policinë e Kosovës për **gjashtë (6) vjet**, në përputhje me kontratën për kthimin e investimit;
- Kandidatët që arsimin e mesëm e kanë përfunduar jashtë Republikës së Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar diplomën nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Nuk kanë të drejtë aplikimi zyrtarët që tashmë kanë të përfunduar studimet e nivelit Bachelor.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Aplikimi bëhet vetëm në formë fizike.

Formulari i aplikimit duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet në vijim:

- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e kartelës identifikuese të punës;
- Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të arsimit të mesëm dhe diplomën origjinale, ose kopjet e noterizuara. Për kandidatët që arsimin e mesëm e kanë kryer jashtë Republikës së Kosovës kërkohet edhe vendimi për njohjen (nostrifikimin) e diplomës;
- Letër interesi, me të dhënat kontaktuese (telefon dhe/ose e-mail);
- Curriculum Vitae (CV);
- Një letër rekomandimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;
- Vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon se kandidati është në marrëdhënie pune dhe nuk ka dosje disiplinore aktive për shkelje të rënda apo dënime penale (i lëshuar brenda afatit të shpalljes së konkursit);
- Vendimin për caktimin në pozitë.

Për kandidatët që përzgjidhen për regjistrim në studimet Bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike do të lidhet kontratë ndërmjet Policisë së Kosovës dhe zyrtarit të përzgjedhur, me të cilën zyrtari obligohet që, pas përfundimit të studimeve, të shërbejë në Policinë e Kosovës për **gjashtë (6) vjet**.

DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Dokumentet dorëzohen vetëm në kopje fizike.

1. Sektorët e Burimeve Njerëzore në nivel stacioni janë të obliguar që aplikacionet e pranuar, të evidentuara në regjistër të veçantë, t'i përcjellin në Sektorët Rajonalë të Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Rajonale përkatëse.
2. Sektorët Rajonalë të Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Rajonale janë të obliguar që aplikacionet e pranuar, të evidentuara në regjistër të veçantë, t'ia dorëzojnë **Divizionit të Trajnimeve në DPP**, brenda **tre (3) ditëve të punës** nga data e përfundimit të afatit për aplikim.
3. Për zyrtarët e Drejtorive në kuadër të DPP-së, aplikacionet dorëzohen drejtpërdrejt në **Divizionin e Trajnimeve në DPP**.

Studimet Bachelor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës ofrohen **pa pagesë dhe pa ndërprerje të marrëdhënies së punës**.

AFATI I KONKURSIT

Konkursi do të jetë i hapur për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike.
Dokumentet pranohen nga data 03.08.2026 deri më 17.08.2026, në ora 16:00.

MËNYRA E TESTIMIT

Kandidatët do të njoftohen me kohë për datën, vendin, orën dhe mënyrën e testimit pas përfundimit të afatit të konkursit.

Kandidatët që i nënshtrohen testit me shkrim duhet të kenë me vete një dokument identifikimi valid. Gjatë testimit nuk lejohet përdorimi i telefonave mobil apo i ndonjë pajisjeje tjetër elektronike.

SHPLLJA E REZULTATEVE

Rezultatet e testimit do të publikohen brenda **dy (2) ditëve të punës** në faqen e brendshme zyrtare të Policisë së Kosovës (**INTRANET**).

ANKESAT

Kandidatët që nuk përzgjidhen kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë Komisionit Përzgjedhës brenda afatit të përcaktuar pas shpalljes së rezultateve.

Komisioni do t'i shqyrtojë ankesat dhe do të vendosë për to brenda **dy (2) ditëve të punës**.

INFORMATA SHITESË

Për informata shtesë, kandidatët mund të kontaktojnë **Divizionin e Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (DPP), Prishtinë**.